



QTTB-Vlore

KARTË TEKNOLOGJIKE.

Miza e ullirit (*Bractocera oleae* Gmelin)

1-Monitoromi i insekteve të rritur të mizës ka rëndësi të vecantë sidomos kur duhen bërë ndërhyrje preventive adulticide, duke përdorur eshkat proteinike. Kurthet me ngjyrë të verdhë ose ato me feromone vendosen nga muaji Qershor , në lartësinë e mesit të pemës duke përdorur 4-6 copë për 1 ha.



Monitorimi me kurthe te verdha.

Ndërhyrja me eshka proteinike bëhet kur kapen 2-3 miza/kurth në javë. Ndërhyrjet adulticide bëhen me trajtime te lokalizuara, duke përdorur eshka proteinike të helmuara me insecticide. Spërkatet 1 metër katror në kurorë nga ana e lindjes. Në 100 litra ujë hidhen 1 kg. eshkë proteinike +300 gr. Dimetoat 20% ose përdoret preparati Sukkses-0.24 CB ku një liter preparat hidhet në 30 litra ujë dhe spërkatet ulliri në një meter kurorë nga ana e lindjes. Këto trajtime fillojnë kur konstatohen çpimet e para ne kokërr nga miza dhe përsëriten çdo 21 ditë, duke kryer deri në 5 trajtime në sezon.

2-Në rastin kur mendohet që për mbrojtjen e prodhimit duhen bërë trajtime totale me preparate kimike është e nevojshme të bëhet analiza për infeksionin të një mostre (kampioni) prej 100 kokrrash ulli të marra në mënyrë rastësore në parcelë. Kufijt e këshilluar të ndërhyrjes janë:

- për ullinjtë për tavolinë , kur vërehen shpimet e para.
- për ullinjtë për vaj, 10-15 % e infeksionit aktiv



Analiza e infeksionit aktiv, muaji Shtator-Tetor.

Prekjet e para vërehen ne kultivarët e hershëm (Frantoi, Lecino dhe kultivarë tavoline), ndërsa infeksionet e larta vërehen në muajt Tetor- Nëntor.

Preparatet më të efektëshme ndaj mizës janë ato me bazë estere fosfori si : Dimetoat 0.2%, Fenitrothion 0.2%, Fenthion 0.2%, Fosfamidon 0.2%.

3-Metoda e kapjes masive . Kjo metodë bazohet në vendosjen e Eco-Trapeve e cila përfaqson një qeskë të mbushur me kripë acetati e zhytur në solucion Deltametrine (Decis) e kombinuar edhe me një ferromon seksual.Vendosja e këtyre qeskave në ulli bëhet në muajin Qershor dhe Shtator.



Eco-trap I vendosur në muajin Shtator.

4- Ndërhyrjet agronomike.Përzgjedhja e kultivarëve më pak të prekshëm,të mos mbillen bashkë varietete për vaj me ata për tavolinë,mbledhja e gjithë prodhimit të mbetur në pemë, vjeljet e parakohëshme te prodhimit etj.

Përgatiti
Agr. Mendim Baçaj